



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi  
VENDIM**

**Nr. 122, datë 29.07.2019**

**MBI**

**MIRATIMIN E DRAFT KONTRATËS NDËRMJET “KESH” SH.A DHE  
“OSHEE”SHA/OSSH, PËR SHIT-BLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE, QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS  
SË KLIENTEVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL ME QËLLIM  
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDAJES PËR PËRIUDHËN  
KOHORE 01.01.2019 – 31.12.2019**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, gërma h) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshur; neneve 104 dhe 113 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr.96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.07.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, lidhur me “Miratimin e kontratës ndërmjet “KESH” sh.a dhe “OSHEE”sh.a, për shit-bletjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndajes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”

**Konstatoi se:**

- Me Vendimin e bordit nr. 90, datë 31.05.2019, ERE, pas kërkesës së KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. nëpërmjet shkresave nr. 2264/1 Prot, dhe nr. 2264 Prot, datë 13.05.2019, protokolluar me nr. 340/1, datë 15.05.2019 dhe Nr. 340, datë 15.05.2019 filloi procedurat për miratimin e Kontratës ndërmjet “KESH”sha dhe “OSHEE”sha, për shit-bletjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”.
- ERE me shkresën me nr. 340/2 Prot, date 13.06.2019 u ka kërkuar palëve informacion për ndryshimet e konstatuara në nenin 4 të kësaj kontrate, nga ajo e miratuar me Vendimin e ERE-s nr, 98 datë 30.04.2018, e lënë në fuqi me vendimin e bordit të ERE-s nr.16, datë 18.02.2019.

- “KESH”sha me shkresen nr. 340/5 Prot, datë 12.07.2019 drejtuar ERE-s dhe për dijeni “OHEE sha është shprehur lidhur me arsyet e ndryshimeve të konstatuara në nenin 4 të kontratës, në krahasim me parashikimet e kontratës së miratuar me vendim të ERE nr. 98, datë 30.04.2018, lënë në fuqi me Vendim të ERE nr. 16, datë 18.02.2019. “KESH” sh.a shprehet se përgjatë zbatimit të kësaj kontratë në periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018, nga ana e palëve është parë e nevojshme që çështje të faturimit të saktësohen dhe se këto ndryshime lidhen edhe me përmbushjen e kontratës tjetër që ekziston mes palëve, atë të shit-blerjes së energjisë elektrike për plotësimin e kërkesës për energji elektrike të klienteve fundorë që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit.
- ERE me shkresën me nr. 340/3 Prot, datë 13.06.2019 u njoftoi vendimin e bordit nr. 90, datë 31.05.2019 subjekteve si: “Ministria e Ekonomisë dhe Financave”; “Ministria e Infrastruktursë dhe Energjisë” dhe “Autoritetit të Konkurrencës” duke kërkuar prej tyre të shprehin opinionet apo komente rreth këtij vendimi, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni.
- Autoriteti i Konkurrencës në shkresën e tij me nr. 381/2 prot, datë 02.07.2019 protokolluar në ERE me nr. 340/4 Prot, datë 03.07.2019 ka shprehur opinionin e tij duke cituar se: *“Kontrata me kushtet e saj e dakordësuar mes palëve “KESH” sha dhe “OSHEE”sha, nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar”.*
- Në zbatim të nenit 20, gërma h) të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ERE është organi kompetent për miratimin e Kontratës ndërmjet “KESH”sha dhe “OSHEE”sha, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”
- Dakortësia e palëve mbi “Kontratën ndërmjet “KESH”sha dhe “OSHEE”sha, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019”, është shprehur nëpërmjet nënshkrimit nga palët.
- Asnjë nga palët e vëna në dijeni nuk ka shprehur kundërshti mbi ndryshimet e propozuara nga KESH sh.a dhe OSHEE sh.a, lidhur me procedurën e nisur me Vendimin nr. 90, datë 31.05.2019 të bordit të ERE-s,
- Palët me vullnetin e tyre, kanë parashikuar shtrirjen e fuqisë juridike të kësaj kontrate nga data 01.01.2019 deri në 31.12.2019.
- KESH sh.a ka deklaruar në mbledhjen e bordit të datës 29.07.2019, se periudha e mbuluar nga kontrata e vitit 2018, lënë në fuqi me vendimin e ERE nr.16, datë 18.02.2019, deri në miratimin e kontratës së vitit 2019, nuk ka prodhuar efekte financiare për palët, e në të tilla rrethana me hyrjen në fuqi të kontratës së vitit 2019, nuk do të ketë nevojë për rakordime e korrigjime mes palëve për periudhën 01.01.2019- 29.07.2019.
- Bordi i ERE me vendimin nr.16, Datë 18.02.2019, ka vendosur mes të tjerave :
  1. Shtyrjen e afatit të zbatimit të Kontratës për shit – blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes,

miratuar me Vendimin e ERE-s nr. 98, datë 30.04.2018, deri në paraqitjen e draft kontratës për vitin 2019 nga KESH sh.a dhe OSHEE sh.a dhe miratimin e saj nga ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. “Miratimin e “Kontratës ndërmjet “KESH” sh.a dhe “OSHEE” sh.a, për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019” ( me nr. 2264/1 prot, datë 13.05.2019 të paraqitur nga KESH sh.a dhe me nr.10572/1 prot, datë 13.05.2019 të paraqitur nga OSHEE sh.a ( bashkëlidhur).
2. Shfuqizimin e pikës 1 të vendimit të bordit të ERE-s me nr. 16, datë 18.02.2019 “Mbi shtyrjen e afatit të zbatimit të Kontratës për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klienteve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018.”
3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 01.01.2019.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**